

Racizmi dhe diskriminimi racor janë realitete shoqërore që prekin të gjitha fushat e jetës.

■ Shprehjet, veprimet dhe sjelljet raciste nuk manifestohen vetëm ballë për ballë dhe drejtpërsëdrejti. Ekziston, po ashtu, një lloj racizmi i përditshëm, «forma delikate të diskriminimit racial, të tilla si injorimi, përqeshja ose trajtimi ndryshe».

- Diskriminimet mund të kenë të bëjnë me:
- Aksesin për punësim, largimin nga puna;
 - Aksesin në të mira materiale dhe shërbime private (strehim, kredi, argëtim);
 - Aksesin në shërbime publike (edukim dhe shkollim).

Është e rëndësishme të njihni dhe të kërkoni të drejtat tuaja. Po ashtu, është e rëndësishme të dëshmoni për një situatë të natyrës raciste ose diskriminuese, kur përballeni me të.

Per cdo takim, ju mund te kontaktoni:

**Service de la cohésion
multiculturelle:**

Place de la Gare 6
2300 La Chaux-de-Fonds
Tel. +41 (0)32 889 74 42
Fax +41 (0)32 722 04 04
Email : cosm@ne.ch

PERMANENCES DU COSM :

La Chaux-de-Fonds

Place de la Gare 6
2300 La Chaux-de-Fonds
Nga e hëna në të enjte :
nga 13:30 deri më 17

Neuchâtel

Rue de Tivoli 22
2000 Neuchâtel
Nga e hëna në të enjte :
nga 13:30 deri më 17

Fleurier

Rue du Temple 8
2114 Fleurier
Të enjten :
nga ora 13:30 deri më 17



ne.ch

Për të ditur më shumë :

**Service de la cohésion
multiculturelle**

www.ne.ch/cosm

**Commission fédérale
contre le racisme CFR**

Inselgasse 1
CH-3003 Berne
Tel. +41 58 464 12 93
ekr-cfr@gs-edi.admin.ch
www.ekr.admin.ch

**Service de lutte contre
le racisme (SLR)**

Secrétariat Général DFI

Inselgasse 1
CH-3003 Berne
Tel. +41 58 464 10 33
ara@gs-edi.admin.ch
www.slr.admin.ch

www.ne.ch/cosm

© Sarah Zaffèri

ne.ch



TË DREJTAT

**RACIZMI
DISKRIMINIMI**

DISKRIMINIMI

**NJIHNI TË
DREJTAT TUAJA**

ÇFARË DUHET BËRË NË SITUATA RACIZMI APO DISKRIMINIMI RACIAL?

A jeni **viktimë** apo jeni **dëshmitar** i shprehjeve ose veprimeve raciste? A besoni se mund të jeni diskriminuar për shkak të origjinës suaj, përka-tësisë fetare apo ngjyrës së lëkurës tuaj, nga një individ, nga një shoqatë, nga një kompani, nga një shërbim publik? Ju mund të kontaktoni shërbimin e kohezionit multikulturor (COSM) për t'ju informuar, këshilluar dhe udhëzuar.

Bashkëpunëtorë-re të COSM-it janë në dispozicion :

- Për t'ju dëgjuar
- Për të identifikuar situatën e diskriminimit
- Për të dhënë informacione dhe këshilla për veprimet ligjore
- Për të ofruar mbështetje administrative
- Për të sugjeruar një ndërmjetësim

Konsultimet i ofrohen kujtdo që është viktimë ose dëshmitar i racizmit dhe/ose diskriminimit, pavarësisht nga statusi i tyre i vendbanimit. Konsultimet janë falas dhe konfidenciale e nëse është e nevojshme, me një përkthyes.

MISIONET E COSM-ËT

COSM-i ka përgjegjësinë e koordinimit të politikës së integrimit ndërkulturor të kantonit të Neuchâtel-it.

Misionet dhe shërbimet e tij përcaktohen nga ligji për integrimin dhe kohezionin multikulturor (RSN 132.04).

Qëllimi i këtij ligji është të promovojë **kohezionin social, dinjitetin e barabartë** dhe **mirëqenien** e të githë atyre që jetojnë në kantonin e Neuchâtel-it, veçanërisht përmes marrëdhënieve harmonike dhe mirëkuptimit të ndërsjellë midis popullatës zvicerane dhe të huaj ose atyre që vijnë nga emigracioni.

Ai inkurajon kërkimin dhe zbatimin e zgjidhjeve për integrimin ndërkulturor, pjesëmarrjen e plotë në shoqëri të njerëzve me origjinë nga emigracioni dhe, në përgjithësi, tenton **të promovojë të drejta dhe detyra të barabarta si dhe mosdiskriminim** për të gjithë brenda kufijve të Kushtetutës dhe të ligjit. » (Neni 1).

Shteti i Neuchâtel-it dëshiron të jetë shembullor për sa i përket menaxhimit të diversitetit. Në vitin 2018, ai krijoi një Udhërrëfyes për një administratë të barabartë e të hapur ndaj diversitetit, ndërkohë që vazhdon të mbështesë aksionet e ndërgjegjësimit dhe informimit (Java e aksionit kundër racizmit në Neuchâtel, Neuchâ-ti, Dita e Refugjatëve).

Për të ditur më shumë:



ÇFARË THOTË LIGJI ?

Në Zvicër, racizmi dhe diskriminimi racial janë të ndaluara me ligj.

Veprimet dhe shprehjet me karakter racist si dhe diskriminimi racial përbëjnë vepra të dënueshme sipas kushteve të përcaktuara në ligjin penal kundër diskriminimit dhe nxitjes së urrejtjes raciale.

Kështu, sipas nenit 261bis të Kodit Penal (CP) dhe 171c të Kodit Penal Ushtarak (CPM), **aktet që konsistojnë në mohimin publik**, në mënyrë eksplicite ose të nënkuptuar, **të së drejtës për barazi** të individëve të caktuar për shkak të ngjyrës së lëkurës së tyre, origjinës së tyre etnike, fesë apo orientimit të tyre seksual **janë të dënueshme**, ashtu si edhe refuzimi për të ofruar shërbime ose të mira materiale të destinuara për përdorim publik, për motive raciste.

RËNDËSIA E RAPORTIMIT DHE DËSHMISË NË LUFTËN KUNDËR AKTEVE DHE DISKRIMINIMIT RACIAL

Regjistrimi i rasteve të racizmit dhe diskriminimit racial kontribuon në monitorimin kombëtar të luftës kundër racizmit. Është e rëndësishme të dëshmosh dhe/ose të raportosh rastet që paraqiten.

COSM-i është anëtar i rrjetit të qendrave të këshillimit për viktimat e racizmit në Zvicër. Humanrights.ch* është organizata që koordinon këtë rrjet dhe që liston çdo vit të gjitha incidentet raciste dhe aktet e diskriminimit të denoncuar në kuadër të qendrave të konsultimit.

Çdo vit publikohet një raport analize i përbashkët nga Humanrights.ch dhe Komisioni Federal kundër Racizmit (CFM).

* Ligji penal kundër diskriminimit racial ka hyrë në fuqi më 1 janar 1995. Që nga 1 korriku 2020, ai ka përfshirë të gjitha diskriminimet e bazuara në orientimin seksual.

Përmbajtja e ligjit penal: <https://www.humanrights.ch/fr>